



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 1657 Prot

Tiranë, më 23 / 12 / 2020

REKOMANDIM

Nr. 37 , datë 23 / 12 / 2020

PËR PROGRAMIN E TRANSPARENCËS SË AUTORITETIT PUBLIK “BASHKIA MALIQ”

Në mbështetje të neneve 6, 7 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, shkronjës f) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim “LDI”), Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ka kryer monitorimin on-line në faqen zyrtare: <https://sites.google.com/view/bashkia/home>, të Autoritetit Publik “Bashkia Maliq” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Bazuar në nenin 4 të LDI, Autoriteti Publik ka detyrimin të vendosë në zbatim programin institucional të transparencës, sipas Urdhërit nr. 211, datë 10.09.2018 “Për miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore” të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në të cilin përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhen publike pa kërkesë.

Ky program, vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës Autoriteti Publik ndërton dhe rrit transparencën në veprimtarinë e tij institucionale, nëpërmjet përditësimit dhe pasurimit të vazhdueshëm të tij, në referencë edhe të pikës 2 të nenit 5 të LDI.

Në lidhje me monitorimin e kryer, nga Drejtoria për të Drejtën e Informimit, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim "Komisioneri"), konstaton se Autoriteti Publik, në menunë kryesore të faqes zyrtare ka të publikuar rubrikën "Transparenca" në brendësi të së cilës është ikona "Programi i Transparencës" ku janë vendosur fushat e programit të transparencës të ndara në ikona të veçanta, në përputhje me modelin e miratuar me Urdhërin nr. 211, datë 10.09.2018 "Për miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore" të Komisionerit. Në këto fusha është ndërlidhur pjesërisht informacioni i cili është pjesë përbërës i programit të transparencës dhe pjesa tjetër gjendet në faqen kryesore. Gjithashtu kanë mbetur pa u publikuar disa kategori informacioni që bëhet publik pa kërkesë.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se pavarësisht se një pjesë e informacionit publik pa kërkesë është publikuar në faqen zyrtare, Autoriteti Publik duhet t'i përmbahet programit model të transparencës të miratuar nga Komisioneri me Urdhërin nr. 211, datë 10.09.2018 "Për miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore", sipas gjetjeve të pasqyruara në lidhjen nr. 1 të këtij rekomandimi.

Detyrimi për bërjen transparente të veprimtarisë së tyre, njësive të vetëqeverisjes vendore i'u lind gjithashtu edhe në zbatim të Kreut VI, të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar. Konkretisht në nenin 15 të ligjit të sipërcituar "Transparenca e veprimtarisë së njësive të vetëqeverisjes vendore", parashikohet se: "*1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore garantojnë për publikun transparencën e veprimtarisë së tyre. 2. Çdo akt i organeve të vetëqeverisjes vendore publikohet në faqen zyrtare të internetit të njësisë vendore dhe afishohet në vendet e caktuara nga njësia për njoftimet publike...*".

Në mbështetje të neneve 6 dhe 7 të LDI dhe shkronjës f) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, nga monitorimi i kryer,

REKOMANDOJ :

1. Autoriteti Publik/Bashkia Maliq të pasqyrojë/ndërlidhë, në programin e transparencës, të gjitha kategoritë e informacionit të detyrueshëm për t'u bërë publike në përputhje me nenin 7 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe Urdhërin nr. 211, datë 10.09.2018 "Për miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore" të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas lidhjes nr. 1 të këtij rekomandimi.
2. Në zbatim të pikës 1 të nenit 32 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, të kryhet plotësimi i detyrimeve të parashikuara

në pikën 1 të këtij rekomandimi, brenda një afati 90 (nëntëdhjetë) ditor nga momenti i marrjes dijeni.

3. Në rast mospërbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas nenit 18, 19 dhe 20 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 23.12.2020

KOMISIONERI

Besnik Dervishi




Lidhja nr.1

Raport i monitorimit për zbatimin e programit institucional të transparencës, bazuar në Urdhërin nr. 211, dt.10.09.2018 “Për miratimin e programit model të transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore” të Komisionerit për të Drejtën e Infomimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për Autoritetin Publik/Bashkia Maliq.

<https://sites.google.com/view/bashkia/home>

Dhjetor 2020



1. Organizimi dhe funksionimi i bashkisë

1.1 Organizimi administrativo-territorial, misioni dhe funksionet

1.1.1 Ndarja administrative territoriale

- Njësitë administrative dhe nën-ndarjet e tyre



Informacioni gjendet i ndërlidhur në programin e transparencës.

1.1.2 Të drejtat, përgjegjësitë dhe misionin e bashkisë

1.1.3 Funkcionet përfshin bërjen publike


- në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike;
- në fushën e shërbimeve sociale;
- në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese;
- në fushën e mbrojtjes së mjedisit;
- në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit;
- në fushën e zhvillimit ekonomik vendor;
- në fushën e sigurisë publike; Funkcionet dhe kompetencat e deleguara

Informacioni nuk është i publikuar në programin e transparencës apo në faqen zyrtare të autoritetit.

1.2 Organi përfaqësues i Bashkisë - Këshilli bashkiak

(perberja, strukturat, detyrat dhe kompetencat). Përfshin bërjen publike të:

- Keshilli Bashkiak - Perberja dhe Struktura (anetaret, Kryetari i këshillit, Sekretari i këshillit, Komisionet, Grupet e këshilltarëve)
- Detyrat dhe kompetencat
- Rregullorja e KB



Informacioni gjendet pjesërisht i ndërlidhur/publikuar në programin e transparencës dhe në faqen zyrtare të autoritetit.

1.3 Organi përfaqësues i Bashkisë - Këshilli bashkiak (procesi i vendimmarrjes). Përfshin bërjen publike të:

- Kalendarit të mbledhjeve të KB
- Njoftimet për mbledhjen e KB
- Rendin e ditës së mbledhjes së KB
- Projekt-vendimet në proces shqyrtimi nga KB



-
- Funksionet e Këshillit**
1. Informimi i Këshillit nga data e konstitimit, sipas nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
 2. Mbledhjet e radhës së Këshillit bashkëkohëzohen si me ligj, sipas përcaktimit që bën vete Këshilli, por jo më pak se një herë në muaj.
 3. Këshilli mbledhet në pdo rast: si me kërkesën e kryetarit të bashkisë; bi me kërkesën me shumicë të jo më pak se 1/3 të anëtarëve të tij; c) me kërkesën e motivuar të prefektit për çështje që lidhen me ushtrimin e funksioneve të tij.
 4. Themja për mbledhjen e Këshillit bëhet nga kryetari i Këshillit dhe njoftimi për mbledhjen bëhet, si me ligj, jo më pak se 5 ditë para datës së zhvillimit të saj. Njoftimi përmban datën e mbledhjes, orën, vendin dhe rastin e ditës.
 5. Randi i ditës miratohet nga Këshilli.

Mungon informacioni në lidhje me:

- *Kalendarit të mbledhjeve të KB*
- *Projekt-vendimet në proces shqyrtimi nga KB*
- *Procesverbalet e mbledhjeve të KB*

1.4 Organi ekzekutiv (Kryetari i Bashkisë). Përfshin bërjen publike të:

- Procedurat e zgjedhjes
- Detyrat dhe kompetencat
- Të dhënat për arsimin, kualifikimet , paga e kryetarit dhe deklarimi i pasurisë
- Vendimet, urdhëresat dhe urdhrat me karakter normativ
- Orari i pritjes së qytetarëve
- Adresa postare/ elektronike



Informacioni është i publikuar pjesërisht në faqen zyrtare por nuk është i ndërlidhur me programin e transparencës.


Mungon informacioni në lidhje me:


- *Procedurat e zgjedhjes*


- *Detyrat dhe kompetencat*
- *... , paga e kryetarit dhe deklarimi i pasurisë*
- *Vendimet, urdhëresat dhe urdhrat me karakter normativ*
- *Orari i pritjes së qytetarëve*
- *Adresa postare/ elektronike*

1.5 Administrata e bashkisë. Përfshirë bërjen publike:

- Struktura organizative dhe numri i punonjësve
- Rregullore për organizimin dhe funksionimin e administratës
- Struktura e pagave
- Orari i punës së bashkisë, njësive administrative dhe njësive të varësisë
- Detyrat e administratës dhe njësisë administrative
- Organizimi dhe funksionimi i njësive në varësi
- Njoftime për vende të lira pune dhe procedurat e rekrutimit
- Adresa postare ose elektronike e zyrave të bashkisë/njësive administrative/njësive të varësisë
- Drejtuesit e zyrave, njësive administrative dhe njësive të varësisë









Informacioni është i publikuar pjesërisht në faqen zyrtare por nuk është i ndërlidhur me programin e transparencës.


Mungon informacioni në lidhje me:

- *Rregullore për organizimin dhe funksionimin e administratës*
- *Orari i punës së bashkisë, njësive administrative dhe njësive të varësisë*
- *Detyrat e administratës dhe njësisë administrative*
- *Organizimi dhe funksionimi i njësive në varësi*
- *Adresa postare ose elektronike e zyrave të bashkisë/njësive administrative/njësive të varësisë*
- *Drejtuesit e zyrave, njësive administrative dhe njësive të varësisë*

1.6 Mekanizmat monitorues dhe të kontrollit

- Karta e auditimit të brendshëm
- Kodi i etikës për audituesit e brendshëm
- Plani strategjik dhe vjetor i njësive të auditimit
- Raportet e auditimit të brendshëm të ushtruar në bashki
- Cdo raport përfundimtar të kontrollit të jashtëm (KLSH) të ushtruar në bashki
- Planet e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm





Informacioni është i publikuar pjesërisht në faqen zyrtare por nuk është i ndërlidhur me programin e transparencës.


Mungon informacioni në lidhje me:

- *Kodi i etikës për audituesit e brendshëm;*
- *Plani strategjik dhe vjetor i njësisë së auditimit;*
- *Raportet e auditimit të brendshëm të ushtruar në bashki;*
- *Cdo raport përfundimtar të kontrollit të jashtëm (KLSH) të ushtruar në bashki;*
- *Planet e veprimt për zbatim të rekomandimeve të lëna në përfundim të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm.*

1.7 Kërkesa, ankesa, sinjalizime dhe vërejtje që lidhen me

- Procedura për të bërë kërkesë ankesë, vërejtje dhe sinjalizime organeve të bashkisë


- Rregullore e brendshme për procedurën e shqyrtimit, hetimit administrativ, sinjalizimit dhe mekanizmat e mbrojtjes së konfidencialitetit
- Njësine përgjegjëse që regjistron, heton administrativisht dhe shqyrton sinjalizimet
- Adresa postare/elektronike për depozitimin e kërkesave, ankesave, sinjalizimeve dhe vërejtjeve
- Afatet dhe mënyrat e kthimit të përgjigjeve në lidhje me kërkesat, ankesat, vërejtjet



Informacioni nuk është i publikuar në programin e transparencës apo në faqen zyrtare të autoritetit. Në programin e transparencës është publikuar vetëm neni 19 i Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

1.8 Statistikat vendore Kalendar i publikimit të statistikave

- Statistika vendore me të dhëna kyce të bashkisë sipas fushave kryesore dhe të ndara sipas gjinisë
- Strukturën përgjegjëse në bashki për mbledhjen dhe përpunimin e statistikave



Informacioni nuk është i publikuar në programin e transparencës apo në faqen zyrtare të autoritetit.

2. Transparenca dhe llogaridhënia ekonomiko – financiare:


2.1 Kalendari i programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor





Informacioni nuk është i publikuar në programin e transparencës apo në faqen zyrtare të autoritetit.

2.2 Paketa fiskale (taksa dhe tarifa). Përfshin bërjen publike të:


- Baza e taksave dhe e tarifave
- Niveli i taksave
- Përjashtime dhe lehtësime të subjekteve të caktuara
- Afatet e pagesave
- Gjoha dhe kamatvonesa të aplikueshme








Mungon Paketa Fiskale për vitin 2020.



Informacioni është i publikuar pjesërisht në faqen zyrtare dhe në programin e transparencës.

2.3 Plani Strategjik i Zhvillimit të Bashkisë


- Politikat për zhvillimin e qëndrueshëm në një afat kohor jo më pak se 5 vite
- Synimet kryesore për çdo fushë përgjegjëse
- Veprimet që duhen ndërmarrë duke parashikuar edhe kostot përkatëse
- Burimet e financimit



Informacioni nuk është i publikuar në programin e transparencës apo në faqen zyrtare të autoritetit.

2.4 Programi Buxhetor Afatmesëm vendor. Përfshin bërjen publike të:

- Dokumenti i parë i PBA-së
- Dokumenti i rishikuar i PBA-së
- Dokumenti i plotë i PBA-së




Informacioni është i publikuar pjesërisht në programin e transparencës. Nuk aksesohen dokumentet si:

- Programi buxhetor afat - mesëm 2019 – 2021.
- Programi buxhetor afat - mesëm 2020 – 2022.

2.5 Buxheti përfshin bërjen publike të:

- Buxheti vjetor së bashku me dokumentacionin shoqërues (12 dokumente)
- Treguesit financiarë
- Numri i punonjësve buxhetor për çdo njësi shpenzuese
- Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik





Nuk aksesohet Buxheti 2020.



Informacioni është i publikuar pjesërisht në programin e transparencës. Nuk aksesohen dokumentet si: Raport i Monitorimit 8 mujor 2020 (duhet akses ne google Drive). Mungojnë gjithashtu vitet paraardhëse.

2.7 Monitorimi dhe mbikëqyrja e buxhetit

- Raporte të monitorimit të zbatimit të buxhetit (jo më pak se tre raporte 4-mujore)
- Raporti vjetor i konsoliduar i zbatimit të buxhetit (raporti i performancës vjetore dhe pasqyra financiare vjetore)
- Raportit të performancës vjetore
- Pasqyrave financiare vjetore (dokumentacionin bazë dhe shoqërues)
- Informacioni mbi zbatimin dhe monitorimin e kontratave (punë publike, mallra, shërbime)
- Regjistri i realizimeve të procedurave të prokurimit publik




Informacioni është i publikuar pjesërisht në programin e transparencës. Mungojnë raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit për vitin 2020 (raporte 4-mujore, të performancës vjetore etj).

Gjithashtu rezulton i pa publikuar:

- *Informacioni mbi zbatimin dhe monitorimin e kontratave (punë publike, mallra, shërbime)*
- *Regjistri i realizimeve të procedurave të prokurimit publik.*

2.8 Vështirësitë Financiare

- Plani për daljen nga situata e vështirë financiare



Informacioni nuk është i publikuar në programin e transparencës apo në faqen zyrtare të autoritetit.

2.9 Shitja ose dhënia me qera e pronave dhe asetëve

- Asete dhe prona të ofruara për shitje ose dhënie me qera
- Kriteret që duhen plotësuar

Informacioni nuk është i publikuar në programin e transparencës apo në faqen zyrtare të autoritetit.

2.10 Donacione



- Emri i donatorit
- Shuma e donacionit
- Qëllimi i donacionit


Informacioni nuk është i publikuar në programin e transparencës apo në faqen zyrtare të autoritetit.

3. Për kërkesat për informacion

3.1 Të dhënat e koordinatorit për të drejtën e Informimit (Emër, kontaktet dhe kompetencat). Përfshin bërjen publike të:

- Emrit mbiemrit të Koordinatorit
- Adresa postare / elektronike
- Detyra dhe kompetenca
- Orari punës
- Adrese postare / elektronike për depozitimin e kërkesave






Informacioni është i publikuar në programin e transparencës.

3.2 Standarde dhe procedura që duhen ndjekur për të bërë kërkesë për informim dhe ankesës. Përfshin bërjen publike të:

- Procedurës që duhet ndjekur për të bërë një kërkesë për informacion
- Adresë postare / elektronike për dërgimin e kërkesës për informim
- Modeli standard i kërkesës
- Afatet për marrjen e përgjigjes
- Procedura që duhet ndjekur për të bërë një ankesë për mos dhënie informacioni
- Adresë postare / elektronike për dërgimin e ankesës për mos dhënie informacion






Informacioni është i publikuar pjesërisht në programin e transparencës. Mungojnë informacionet si:


- Modeli standard i kërkesës (nuk aksesohet)
- Procedura që duhet ndjekur për të bërë një ankesë për mos dhënie informacioni
- Adresë postare / elektronike për dërgimin e ankesës për mos dhënie informacion (nuk aksesohet)

3.3 Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve. Përfshin bërjen publike të

- Të gjitha kërkesat për informim
- Informacionet e dhëna në përgjigje të kërkesave për informim
- Përditësimi i regjistrit



Nr. rrethet	Data e regjistrimit të kërkesës	Objekti	Data e kthimit të përgjigjes	Statusi i kërkesës	Tarifa
1	09.06.2019	Kërkesë për informim nga Komiteti i përbashkët për të Drejtat e Individit dhe Mbrojtjen e të Dënuarve Personale	02.08.2019	Zgjidhur	Pa pagesë
2	15.11.2019	Kërkesë për informim nga ASJA Shkurt	21.11.2019	Zgjidhur	Pa pagesë
3	19.11.2019	Kërkesë për informim	22.11.2019	Zgjidhur	Pa pagesë
4	20.12.2019	Kërkesë për informim nga ASJA Shkurt	26.12.2019	Zgjidhur	Pa pagesë




Informacioni nuk është i përditësuar. Përditësimi i fundit 20.12.2019. Regjistri Janar-Shkurt-Mars 2020 nuk aksesohet. Mungojnë: Informacionet e dhëna në përgjigje të kërkesave për informim.

3.4 Informacion i dhënë më parë

Informacioni nuk është i publikuar në programin e transparencës apo në faqen zyrtare të autoritetit.

3.5 Trajtimi i kërkesave për informacion


- Procedura e regjistrimit të kërkesës në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve
- Afatet e trajtimit të kërkesës nga ana e administratës së bashkisë
- Mënyrat e dhënies së informacionit



Informacioni është i publikuar pjesërisht programin e transparencës.

3.6 Kufizimi i së drejtës së informimit

- Rastet e kufizimit të së drejtës për informim



Informacioni është i publikuar në programin e transparencës.

3.7 Tarifa për dhënien e informacionit nëse ka

- Niveli i tarifës
- Rregulla për mënyrën e kryerjes së pagesës
- Subjekte që përftojnë informacion falas

Informacioni nuk është i publikuar në programin e transparencës apo faqen zyrtare të autoritetit.

3.8 Informacionet dhe dokumentet që kërkohen shpesh

- Gjithë informacioneve dhe dokumenteve të kërkuara më shpesh nga publiku me kërkesë për informim"

Informacioni nuk është i publikuar në programin e transparencës apo faqen zyrtare të autoritetit.


4. Mbi shërbimet që ofron bashkia



4.1 Shërbimet Përfshin bërjen publike të shërbimeve publike që ofron Bashkia sipas fushave të përcaktuara ligji 139/2015

- "Shërbimet në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike"
- "Shërbimet në fushën e shërbimeve sociale"
- "Shërbimet në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese"
- Shërbimet në fushën e mbrojtjes së mjedisit
- "Shërbimet në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit"
- "Shërbimet në fushën e zhvillimit ekonomik vendor"
- "Shërbimet në fushën e sigurisë publike"
- "Shërbimet në fushën e funksioneve dhe kompetencave të deleguara"

Për çdo shërbim (por pa u kufizuar) informacion përshkrues mbi:

- Instrument për administrimin e shërbimit
- Sistemin e administratës të performancës së shërbimit bazuar mbi standardet
- Sistemin e treguesve, përfshirë edhe aspektin gjinor për matjen e performancës
- Strukturën përgjegjëse për prezantimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e performancës së shërbimit, përfshirë edhe aspektin gjinor





4.2 Shërbimet administrative Përfshin bërjen publike të shërbimeve publike që ofron Bashkia sipas fushave të përcaktuara ligji 139/2015

- Shërbimet administrative në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike
- Shërbimet administrative në fushën e shërbimeve sociale
- Shërbimet administrative në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese
- Shërbimet administrative në fushën e mbrojtjes së mjedisit

- Shërbimet administrative në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave
- publike, natyrës dhe biodiversitetit
- Shërbimet administrative t në fushën e zhvillimit ekonomik vendor
- Shërbimet administrative në fushën e sigurisë publike
- Shërbimet administrative në fushën e funksioneve dhe kompetencave të deleguara

Për cdo shërbim (por pa u kufizuar) informacion përshkrues mbi

- Strukturat përgjegjëse për ofrimin e shërbimit;
- adresën postare/elektronike të strukturave/njësive/sportelevë që ofrojnë shërbime administrative;
- procedurat që duhen ndjekur për të përfituar shërbime administrative;
- Oraret e punës së strukturave/njësive/sportelevë që ofrojnë shërbime administrative;
- Tarifat për shërbimet administrative;
- Rregullat për mënyrën e kryerjes së pagesës;
- Subjektet që përjashtohen nga tarifat"

Informacioni është i publikuar pjesërisht në faqen zyrtare të autoritetit por nuk është i ndërlidhur me programin e transparencës.



4.3 Kontratat publike përfshin bërjen publike të:

- Objektit të kontratës publike
- Numrit të referencës së procedurës/ kontratës
- Llojit të procedurës
- Termave dhe kushteve të kontratës
- Kohëzgjatjes së kontratës
- Vlerës së kontratës
- Dhënave të autoritetit kontraktor
- Dhënave të kontraktorit/nënkontraktorit
- Treguesve për matjen e përmbushjes së kontratës
- Strukturave publike përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe monitorimin e kontratës
- Procedurave që duhet ndjekur për të bërë një ankimim
- Raporteve të kontrollit, monitorimit dhe auditimit mbi zbatimin e kontratës

Informacioni nuk është i publikuar në programin e transparencës apo faqen zyrtare të autoritetit.

4.4 E drejta e ankesës dhe vërejtjes në lidhje me shërbimet

- Procedurave për të bërë ankesa apo vërejtje në lidhje me shërbimet
- Adresës postare/elektronike për depozitimin e ankesave apo vërejtjeve



Informacioni është i publikuar pjesërisht në programin e transparencës. Mungon procedura për të bërë ankesa apo vërejtje në lidhje me shërbimet si dhe adresa postare/elektronike për depozitimin e ankesave apo vërejtjeve.


5. Legjislacioni dhe aktet e brendshme rregullatore. I organizuar (jo i detyrueshëm) sipas fushave:

- Fusha e organizimit dhe funksionimit të bashkisë;
- Fusha e veprimtarisë ekonomiko-financiare;
- Fusha e transparencës dhe pjesëmarrjes qytetare;
- Fusha e infrastrukturës dhe shërbimeve publike;

- Fusha e shërbimeve sociale;
- Fusha e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese;
- Fusha e mbrojtjes së mjedisit;
- Fusha e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit;
- Fusha e zhvillimit ekonomik vendor;
- Fusha e sigurisë publike;
- Fusha e funksioneve dhe kompetencave të deleguara.

Çdo fushë duhet të përmbajë:

- Aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse;
- dokumentet politike kombëtare përkatëse;
- Vendimet, urdhëresat dhe urdhrat e këshillit të bashkisë me karakter normativ;
- Vendimet, urdhëresat dhe urdhrat e kryetarit të bashkisë me karakter normativ;
- Dokumentet politike vendore




Informacioni është i publikuar/i ndërlidhur në programin e transparencës.

6. Pjesëmarrja qytetare në vendim-marrje

6.1 Të dhënat e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik

- Emër mbiemër të koordinatorit
- Adresën postare/elektronike të tij
- Orarin e punës



Informacioni është i publikuar/i ndërlidhur në programin e transparencës.

6.2 Plani vjetor për procesin e vendimmarrjes me pjesëmarrje"

- Aktet që do të konsultohen
- Mënyra e konsultimit

- Afatet
- Strukturat përgjegjëse

PLAN VJETOR PER PROCESIN E VENDIMARRIES ME PËRSEMARRJE.docx

No DREJTORIA	Programet e Zhvillimit te Buxhetit	Aktoret	Vendi i takimit	Data	Ora
1. Drejtoria e Planifikimit kontrollit dhe Zhvillimit te Terrenit	Hartimi i Planit te Pergjithshem Vendet Faza I	Parlamenti Kuvendi i Organizimit te qeverise dhe qeveriseve te ndihmeve dhe bashkimit te Koditit Buxhetit et.	Salla e Koditit Buxhetit		
Drejtoria e Planifikimit kontrollit dhe Zhvillimit te Terrenit	Hartimi i Planit te Pergjithshem Vendet Faza II				
2. Drejtoria e Financave dhe Buxhetit	Hartimi i Planit te Pergjithshem Vendet Mars 2020	Nyrene Administrative (Pjesa: Llogarit, Vendet, Paga, Gera, Mbledhje, Mbledhje Qendrore)	Sipos Kuvendi te qeveriseve te ndihmeve te bashkimit te koditit		
Drejtoria e Financave dhe Buxhetit	Hartimi i Planit te Pergjithshem Vendet Mars 2020	Nyrene Administrative (Pjesa: Llogarit, Vendet, Paga, Gera, Mbledhje, Mbledhje Qendrore)	Sipos Kuvendi te qeveriseve te ndihmeve te bashkimit		

PLAN VJETOR PER PROCESIN E VENDIMARRIES ME PËRSEMARRJE.docx


No DREJTORIA	Programet e Zhvillimit te Buxhetit	Aktoret	Vendi i takimit	Data	Ora
2. Drejtoria e Financave dhe Buxhetit	Hartimi i Planit te Pergjithshem Vendet Mars 2020	Nyrene Administrative (Pjesa: Llogarit, Vendet, Paga, Gera, Mbledhje, Mbledhje Qendrore)	Sipos Kuvendi te qeveriseve te ndihmeve te bashkimit		
Drejtoria e Financave dhe Buxhetit	Hartimi i Planit te Pergjithshem Vendet Mars 2020	Nyrene Administrative (Pjesa: Llogarit, Vendet, Paga, Gera, Mbledhje, Mbledhje Qendrore)	Sipos Kuvendi te qeveriseve te ndihmeve te bashkimit		
Drejtoria e Planifikimit kontrollit dhe Zhvillimit te Terrenit	Hartimi i Planit te Pergjithshem Vendet Mars 2020	Nyrene Administrative (Pjesa: Llogarit, Vendet, Paga, Gera, Mbledhje, Mbledhje Qendrore)	Sipos Kuvendi te qeveriseve te ndihmeve te bashkimit		

Couldn't preview file
There was a problem loading more pages.

Informacioni është pjesërisht i publikuar/i ndërlidhur në programin e transparencës (gjenerohet vetëm fq e parë).

6.3 Dispozitat e brendshme rregullatore për këshillimin me publikun. Përfshin bërjen publike


- Procedurave, afateve dhe mënyrat e organizimit për çdo formë/lloj konsultimi
- Strukturat përgjegjëse për aktet e detyrueshme për konsultim



Informacioni është pjesërisht i publikuar/i ndërlidhur në programin e transparencës. Dispozitat e brendshme rregullatore nuk aksesohen.

6.4 Akte për të cilët është e detyrueshme zhvillimi i konsultimit publik. Përfshin bërjen publike të:


- Listës së akteve për të cilët është e detyrueshme zhvillimi i konsultimit publik



Informacioni është pjesërisht i publikuar/i ndërlidhur në programin e transparencës. Mungon lista e akteve për të cilat është e detyrueshme zhvillimi i konsultimit publik.

6.5 Njoftimi për nismën vendimmarrëse me pjesëmarrje:


- Projektaktit, relacionin shpjegues dhe dokumentave shoqërues të tij;
- Arsyeve të nevojshme për nxjerrjen e projektaktit, si dhe ndikimi që ai do të ketë;
- Afatit, vendit dhe mënyrën me të cilën palët e interesuara paraqesin ose dërgojnë rekomandimet e tyre;
- Adresën e kontaktit të koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik të bashkisë ose të strukturës përgjegjëse për mbledhjen e rekomandimeve e të komenteve për projektaktin;
- Vendin dhe datën e organizimit të takimit publik në rastet kur bashkia vendos për organizimin e tij.



Informacioni është pjesërisht i publikuar/i ndërlidhur në programin e transparencës. Mungojnë informacionet si: Projektakti, relacioni shpjegues dhe dokumentave shoqërues të tij, arsyet e nevojshme për nxjerrjen e projektaktit si dhe ndikimi që ai do të ketë, afatit, vendit dhe mënyrën me të cilën palët e interesuara paraqesin ose dërgojnë rekomandimet e tyre.

6.6 Procedura e marrjes dhe shqyrtimit të komenteve dhe rekomandimeve

- Adresën postare/ elektronike për dërgimin e komenteve dhe rekomandimeve"
- Afatin për dërgimin e komenteve dhe rekomandimeve
- Mënyrën e mbajtjes së procesverbalit dhe regjistrimit të takimit publik për takimet publike
- Mënyrën e trajtimit të komenteve dhe rekomandimeve
- Mënyrën e dhënies së arsyeve për mospranimin komenteve dhe rekomandimeve




Informacioni është pjesërisht i publikuar/i ndërlidhur në programin e transparencës. Mungojnë informacionet si:

- Afatin për dërgimin e komenteve dhe rekomandimeve
- Mënyrën e mbajtjes së procesverbalit dhe regjistrimit të takimit publik për takimet publike
- Mënyrën e trajtimit të komenteve dhe rekomandimeve
- Mënyrën e dhënies së arsyeve për mospranimin komenteve dhe rekomandimeve

6.7 Procedurat që duhen ndjekur për të bërë një ankim në lidhje me konsultimin publik. Përfshin bërjen publike të:

- Subjektet ku mund të bëhet ankesa (Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale Këshilli I bashkisë, Kryetari i bashkisë:)"
- Adresën postare/ elektronike për dërgimin e ankesës
- Procedurat për të bërë një ankesë në lidhje me këshillimin me publikun
- Struktura përgjegjëse në nivel bashkie që regjistron dhe shqyrton ankesën



Informacioni është pjesërisht i publikuar/i ndërlidhur në programin e transparencës.

6.8 Raporti vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes.

- Numrit të akteve të miratuara nga organet e bashkisë me konsultim publik gjatë një viti
- Numrin e përgjithshëm të komenteve dhe rekomandimeve të marra nga palët e interesuara
- Numrin e rekomandimeve dhe komenteve të pranuar dhe të refuzuara gjatë procesit të vendimmarrjes
- Numrin e takimeve publike të organizuara

Informacioni nuk është i publikuar në programin e transparencës apo faqen zyrtare të autoritetit.

6.9 Iniciativa qytetare. Përfshin bërjen publike

- Mënyrës dhe formës së paraqitjes së iniciativës qytetare
- Procedurave të shqyrtimit dhe e miratimit të iniciativës qytetare
- Adresës postare/ elektronike për depozitimin e iniciativës qytetare
- Mënyrat dhe afatet e kthimit të përgjigjeve për mos miratimin e iniciativës qytetare.



Informacioni i publikuar në programin e transparencës nuk aksesohet.

7. Informacion tjetër

7.1 Bashkia në proceset e integritetit evropian

- Të dhënave për projektet, nismat dhe veprimtarisë e bashkisë në kuadrin e integritetit në BE"

Informacioni nuk është i publikuar në programin e transparencës.

7.2 Bashkia dhe shoqëria civile Në tërësi të dhëna për grupet e interesit

- Të dhëna për OJF, përfaqësuesit e medias, biznesi
- Shërbimet që ofrohen nga organizata të ndryshme
- Nismat advokuese, lobuese dhe monitoruese nga shoqëria civile
- Nismat advokuese, lobuese dhe monitoruese nga shoqëria civile

Informacioni nuk është i publikuar në programin e transparencës.

7.3 Raporte, studime dhe vlerësime mbi zbatimin e Programit të transparencës.

- Raporte, studime dhe vlerësime mbi zbatimin e Programit të transparencës

Informacioni nuk është i publikuar në programin e transparencës.

7.4 Strukturat komunitare. Përfshin bërjen publike të:

- Të dhëna për strukturat komunitare në fshat
- Të dhëna për strukturat komunitare në qytet
- Detyrat, kompetencat dhe kompetencat e strukturave komunitare
- Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e këshillave komunitare

Informacioni nuk është i publikuar në programin e transparencës.